



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1790/10 prot.

Datë 11.09.2026

V E N D I M

Nr.1141/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Gjergj Mersini	Nënkryetar
Donika Daci	Anëtar
Edvin Simo	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.09.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik BOE “Fusha” sh.p.k & “Pastrime Silvio” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-79482-03-18-2026, me objekt: “Mirëmbajtja dhe Menaxhimi i Sheshit “Skënderbej”, me fond limit 132,005,225.27 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 29.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Rrugeve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë (BOE) “A l b G a r d e n” sh.p.k. & “Shpresa - Al” sh.p.k. me NIPT K37513520N, K31321021N dhe adresë: Lagjja Skenderbeg, godinë private 1 katëshe në superstradën Lezhë - Shkodër, km 1 , Lezhë.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Pergjithshme e Rrugeve dhe Ndriçimit Publik Tiranë me adresë Rruga “5 Maji”, Tiranë.

Subjekte të Interesuara:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë (BOE) “Fusha” sh.p.k. me NIPT J61922018S & “Pastrime Silvio” sh.p.k. me NIPT K91413010N dhe adresë: Tiranë,

Njesia Bashkiake nr 2, Rruga Murat Toptani, perballe
Kinema Milenium, godina nr.3, Pedonalja.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar,
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë
19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit
publik”, i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave
nr.291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve
monetarë në procedurat e prokurimit publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me
shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e
lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje
me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat
e Prokurimit Publik.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye
legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe
njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në
ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor
dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.03.2026, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e
prokurimit prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-79482-03-18-2026,
me objekt: “Mirëmbajtja dhe Menaxhimi i Sheshit “Skënderbej”, me fond limit
132,005,225.27 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 29.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria
e Pergjithshme e Rrugeve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.

II.2. Në datën 29.04.2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 18.05.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

BOE Fusha & Pastrime Silvio	98,947,827.47 lekë	Kualifikuar
BOE Alb-Garden & Shpresa Al	99,019,006.8 lekë	Kualifikuar
Clean Fast	127,834,570.73 lekë	Skualifikuar

II.4. Në datën 01.06.2026, është publikuar në SPE, Njoftimit i Fituesit Paraprak për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Në datën 05.06.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6764 si dhe nr. protokoli 1790/2026 datë 08.06.2026 i operatorit ekonomik (BOE) “A l b G a r d e n” sh.p.k. & “Shpresa - Al” sh.p.k., në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga (BOE) “Fusha” sh.p.k & “Pastrime Silvio” sh.p.k, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr.1790/1 prot., datë 08.06.2026.

II.7. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektornike, operatori ekonomik (BOE) “Fusha” sh.p.k & “Pastrime Silvio” sh.p.k në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar në kuptim të nenit 113 të LPP-së, në datën 14.06.2026 ka paraqitur formularin e argumentave, protokolluar me tonën me nr.1790/2 prot., datë 15.06.2026.

II.8. Nëpërmjet shërbimit postar me shkresën nr.558/12 prot., datë 26.06.2026, me objekt “Dërgim vendimi”, protokolluar me tonën me nr.1790/3 prot., datë 01.07.2026, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin e KSHA nr.558/11 prot., datë 26.06.2026, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik (BOE) “A l b G a r d e n” sh.p.k. & “Shpresa - Al” sh.p.k. Referuar vendimit të KSHA rezulton se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj.

II.9. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektornike, operatori ekonomik ankimues (BOE) “A l b G a r d e n” sh.p.k. & “Shpresa - Al” sh.p.k, në datën 16.07.2026 ka paraqitur argumenta

shtesë me nr 1192 prot., datë 16.07.2026, protokolluar me tonën me nr.1790/4 prot., datë 16.07.2026.

II.10. Operatori ekonomik ankimues (BOE) “A l b G a r d e n” sh.p.k. & “Shpresa - Al”sh.p.k argumentat shtesë me nr 1192 prot., datë 16.07.2026 i ka paraqitur pranë Komisionit të prokurimit Publik edhe nëpërmjet shërbimit postar, protokolluar me tonën me nr.1790/5 prot., datë 17.07.2026.

II.11. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektornike, operatori ekonomik ankimues (BOE) “A l b G a r d e n” sh.p.k. & “Shpresa - Al” sh.p.k, në datën 09.09.2026 ka paraqitur argumenta shtesë me nr 1213 prot., datë 09.09.2026, protokolluar me tonën me nr.1790/6 prot., datë 10.09.2026.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit (BOE) “A l b G a r d e n” sh.p.k. & “Shpresa - Al”sh.p.k për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Fusha” sh.p.k & “Pastrime Silvio” sh.p.k, me arsyen se: “ 1) BOE FUSHA shpk & Pastrime Silvio sh.p.k. nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të kërkuar në pikën 2.3.8 të dst lidhur me mjetet me targa që shënohen në regjistrat publikë. ... Lidhur me këtë kriter kualifikimi, ashtu siç e kemi deklaruar mësipër, duke i patur konkurentë në shumë procedura prokurimi ne i njohim shumë mirë kapacitetet teknike e veçanërisht mjetet që të dy anëtarët e BOE si shoqëria FUSHA sh.p.k., ashtu dhe shoqëria Pastrime Silvio sh.p.k., disponojnë. Në këtë kontekst argumentojmë përpara AK se BOE FUSHA sh.p.k.& Pastrime Silvio sh.p.k., nuk e përmbush kriterin e kërkuar nga AK në pikën 2.3.8 lidhur me mjetet të cilat duhet të shënohen në regjistrat publikë. Më konkretisht në kriterin 2.3.8, në shkronjat a dhe c , përcaktohet se dokumentacioni që duhet të paraqese OE pjesëmarrës në këtë procedurë duhet të përfshijë lejen e qarkullimit dhe fotot e mjetit ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit. Këto dokumenta evidentojnë karakteristikat teknike të mjetit dhe provojnë nëse mjetet e disponuara nga OE konkurues përmbushin kriteret e veçanta, sipas kërkesave dhe specifikave të AK....

2) BOE FUSHA shpk & Pastrime Silvio sh.p.k. nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të kërkuar në pikën 2.3.8 të dst lidhur me mjetet pa targa dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistrat publikë.

Lidhur me këtë kriter kualifikimi, ashtu siç e kemi deklaruar mësipër, duke i patur konkurentë në shumë procedura prokurimi ne i njohim shumë mirë kapacitetet teknike e veçanërisht mjetet dhe pajisjet që të dy anëtarët e BOE si shoqëria FUSHA sh.p.k., ashtu dhe Pastrime Silvio sh.p.k., disponojnë. Në këtë kontekst argumentojmë përpara AK se BOE FUSHA sh.p.k.& Pastrime Silvio sh.p.k., nuk e përmbush kriterin e kërkuar nga AK në pikën 2.3.8 lidhur me

mjetet të cilat duhet të shënohen në regjistrat publikë.... i) Lidhur me mjetet që të dy anëtarët e BOE kanë paraqitur dokumentat e zhdoganimit ne dispojmë informacion se këto mjete nuk e përmbushin kriterin e kërkuara nga AK në pikën 2.3.8, pasi të dhënat dhe karakteristikat teknike të mjeteve nuk janë sipas kërkesave të dst; ii) Lidhur me mjetet që të dy anëtarët e BOE kanë paraqitur faturat tatimore të blerjes, ne dispojmë informacion se këto mjete nuk e përmbushin kriterin e kërkuara nga AK në pikën 2.3.8, pasi të dhënat dhe karakteristikat teknike të mjeteve nuk janë sipas kërkesave të dst...”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë KPP, operatori ekonomik ankimues nuk parashtroi fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori*, duke ngritur dyshime e hamendësimet, lidhur me plotësimin e kriterit 2.3.8 nga operatori ekonomik “Fusha” sh.p.k & “Pastrime Silvio” sh.p.k, pjesëmarrës dhe njëkohësisht fitues paraprak në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.2. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3:

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.*

III.1.3. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.1.4. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve të tjerë ekonomikë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një

procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.1.6 Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar efikasitetin e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krah të operatorit ankimes. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimesit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrajnë pretendime a-priori duke mos identifikuar asnjë element konkret brenda kriterëve të veçanta të kualifikimit, si edhe duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij.

Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se “*Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”

Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “*onus probandi incumbit actori*” se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjitha elementet procedurale, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.1.7. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementeve përbërëse të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.1.8. Lidhur me argumentat shtesë të paraqitur nga operatori ekonomik ankimes pas datës së paraqitjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se këto argumenta nuk do të merren në shqyrtim. Neni 110 i Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, parashikojnë afate të përcaktuara për paraqitjen e ankesës, të cilat synojnë garantimin e parimeve të sigurisë juridike, barazisë së palëve në proces dhe respektimin e afateve procedurale, në funksion të një gjykimi efektiv e në kohë të arsyeshme. Pranimi i argumenteve shtesë të paraqitura pas këtij afati, do të cenonte parimin e sigurisë

juridike dhe barazisë së palëve në proces. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se këto argumente nuk ndikojnë në vlerësimin e themelit të ankesës.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr.291, datë 15.05.2024 *“Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik (BOE) “A l b G a r d e n” sh.p.k. & “Shpresa - Al” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-79482-03-18-2026, me objekt: “Mirëmbajtja dhe Menaxhimi i Sheshit “Skënderbej”, me fond limit 132,005,225.27 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 29.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Rrugeve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga nga operatori ekonomik (BOE) “A l b G a r d e n” sh.p.k. & “Shpresa - Al” sh.p.k.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Gjergj Mersini

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Edvin Simo

Kryetar
Ismail Shehu

